

**“Jashtë bie borë”****Data: 5, 6, 7, 8 maj**

Autor: Vincenzo Salemme

Regjisor: Hervin Çuli



Historia e një familjeje të thjeshtë napolitane, shumë e ngjashme me familjet shqiptare, në kërkim të identitetit të humbur, e treguar përmes humorit dhe situatave komike që përfshijnë 3 vëllezërit shumë «të ndryshëm» të familjes Rigi [Righi].

**SALLA E MADHE / ARTURBINA**

Nën interpretimin fantastik të aktorëve:

HERVIN ÇULI

HELIDON FINO

HYSEN MULLAJONUZI

MARIO ELEZI

REZERVONI VENDIN TUAJ:

BILETARIA: 9:00-13:00 &amp; 16:00-19:00

Tel.: 04 222 3022; 068 2000 650

ÇMIMI: 500 Lekë

**“DITA MË E BUKUR”****Data: 2, 3, 4 maj**

Autor: David Foenkinos

Ora: 19:00

**SALLA E MADHE, ARTURBINA**

Një komedi brilante që do t'ua zbukurojë

Ditën dhe juve!

Një fëmijë është frut i dashurisë së një çifti! Por a mund të jetë kjo «pjata e fundit» e këtij «vakti» (dashurisë)? Ejani të zbuloni ç'ndodh me jetën e Natalisë, Pierrit, Sofisë dhe Michelit dhe infermieres joshëse të maternitetit

REZERVONI VENDIN TUAJ:

BILETARIA: 9:00-13:00 &amp; 16:00-19:00

Tel.: 04 222 3022 | 068 2000 650

ÇMIMI: 500 lekë

## "FLI"

**Në datat: 1, 11, 12, 13, 14, 15 Maj**

Bazuar në veprën "Ifigjenia në Aulidë" nga Euripidi

Regjia: Enton Kaca

Ora 19:00

**Teatri Metropol**



Teatri Metropol prezanton premierën e re me titull "FLI", një konceptim modern dhe aktual i veprës "Ifigjenia në Aulidë" të Euripidit, sjellë në skenë me regji dhe dramaturgji nga Enton Kaca. Kjo vepër, premiera e së cilës do të ngjitet në skenë në datën 28 prill është një nga veprat më të njohura të Euripidit që përfshin brenda intriga, mashtrime, rivalitet politik, luftë, hakmarrje, konflikte, ambicie, vetmohim në skenat kryesore të tragjedisë. A është lufta mjeti i duhur për të zgjidhur konfliktet?! A "sakrifikohet" familja për karrierën personale?! A vlen më shumë krenaria dhe lavdia se arsyeja?!

Interpretojnë:

Amri Hasanlliu, Bujar Hoxhaj, Edvin Mustafa, Erdet Miraka, Ismail Shino, Klodjana Keco, Linda Jarani, Lindar Kaja, Margent Caushi, Mariglen Domi, Mario Bali, Marius Dhrami, Roerd Toçe, Sedmir Memia, Stivi Osmanaj, Vanesa Guri, Xhino Musollari, Xhoni Spahi.

Kori: Ketjona Pecnikaj, Parashqevi Hallkaj

As. Regjisor: Edvin Mustafa

Kostumet: Sofi Kara

Info & Rezervime:

+355 67 227 0668

[www.teatrimetropol.al](http://www.teatrimetropol.al)

## Shfaqja: "Përvjetori i ditëlindjes"

(Premierë)

**Data: 27, 28, 29 Maj**

Ora:19:00

Bashkëpunim mes TK-TKEKS- Bashkia Tiranë & UNICEF

**Salla e madhe 400, Arturbina**

## “ÇIMKA”

**Datat: 4, 5, 6, 7, 11, 12, 13, 14, 15 maj**

Ora: 20:00

**Muzeu Kombëtar “Shtëpia me gjethe”**

Një krijim unik dhe bashkëproduksion i Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Tiranë dhe Qendrës për Art dhe komunitet – Artpolis, Prishtinë.

Autor: Shpëtim Selmani

Regjisore: Zana Hoxha

Aktorë: Lulzim Zeqja, Loredana Gjeçi, Myzafer

Zifla, Xhulia Musagalliu, Mikel Markaj, Edlir Gashi, Urim Aliaj, Altea Dulellari

Kompozitor: Liburn Jupolli

Skenografia dhe Kostumet: Youliana Voykova - Najman

Asistentë regjie: Greta Baci & Kevin Rrapaj



BILETARIA: E MARTË - E DIEL: 9:00-13:00 & 16:00-19:00

ArTurbina

ÇMIMI I BILETËS

E MËRUKRË - E ENJTE: 300 lekë

E PREMTE- E DIEL: 500 lekë

STUDENTË/PENSIONISTË - 300 lekë

Vendet janë të limituara

Rezervoni: 0695717746

## “Vdis duke qeshur”

**Data: 11, 12, 13, 14, 15 Maj**

Ora: 19 : 00

Teatri Kombëtar/Teatri “A.Z.Çajupi”

Salla e madhe 400, Arturbina

## Olen Cesari

**Data: 5, 6 maj**

Ora: 19:30

**Pallati i Kongreseve**

Olen Cesari, violinisti me famë botërore, i shoqëruar nga "International Clandestine Orchestra", rikthehet pas 3 vitesh në Tiranë.

Me mbështetjen e DigitAlb, mos e humbisni!



## Koncert Recital

Gulielm Radoja (02 Korrik 1945 / 05 Maj 2021)

**Data: 5 Maj**

Ora: 19:00

**Odeoni «Nikolin Xhoja» / QK. «A.Moisiu»**

Luan në piano: Red Radoja

## “Për TY Kosovë”

Koncert

Inva Mula

**Data: 7 Maj 2022**

**Live në Klan Arena, Prishtinë**

Koncerti fillon nga ora 20:30.

**Dyert e Klan Arena hapen nga ora 19:00.**

E madhja Inva Mula rikthehet në Klan Arena me koncertin madhështor “Për TY Kosovë”

Biletat mund t'i gjeni online në klanarena.com si dhe në të gjitha pikat Art Motion.

## “Për ty bab”

Data: 9 maj

Koncert

Teatri “Migjeni”, Shkodër

Sopranja Inva Mula dhe pianisti Genc Tukiçi ju ftojnë në një koncert, titulluar “Për ty bab”, dedikuar baballarëve të tyre, artistëve Avni Mula dhe Ibrahim Tukiçi.

Koncertet do të shoqërohen nga bandi Klan Arena, nën drejtimin e mjeshtrit Florent Boshnjaku.

Biletat në Olen.it ose Myticket.al ose në degët e Western Union dhe te Pallati i Kongreseve

## Koncert i Orkestrës Simfonike të RTSH

Datë 9 Maj

Ora: 19.00

ArTurbina

Një koncert i Orkestrës së Radiotelevizionit Shqiptar me një program të mrekullueshëm me veprat e Sibelius dhe Dvorzhak. Me violinistin finlandez Petteri Iivonen, fitues çmimi në konkursin “Sibelius” dhe violina solo e Operas së Parisit, që do të interpretojë koncertin e Sibelius. Nën drejtimin e dirigjentit shumë të njohur finlandez Petri Sakari, i cili ka drejtuar orkestrat më të mëdha europiane dhe ka regjistruar veprën e plotë të Sibelius midis të tjerash.



## REQUIEM – TONIN HARAPI

Data: 10 maj

Ora: 20:00

### SKENA E TKOB

Përfaqësues i një etape me rëndësi në muzikën shqiptare në gjysmën e dytë e shekullit të 20, kontributi i Tonin Harapit konsistoi në krijimin e bazës profesionale dhe fizionomisë së kësaj muzike. Me pjesmarrjen e: Orkestrës Simfonike dhe korit Dirigjent: Dritan Lumshi  
Solistë: Eva Golemi, Denis Skura, Laura Hoxha, Bledar Domi  
Soliste në piano: Etrita Ibrahim

## Trio Reve

Tre koncerte

Datat

1 maj - Shkodër - Teatri Migjeni  
18 maj - Korçë - Teatri Çajupi  
24 maj - Tiranë - Teatri Metropol

16 shekuj muzikë shqiptare, **bazuar** mbi studimet e Ramadan Sokolit dhe Armand Broshka, arranzhues dhe narrator  
Kompozitorë: Niket Dardani, Jan Kukuzeli, Llukë Sorga, Fan Noli, Francoeur, Antonio Albanese, këngë arbëreshe, Ismail Dede Efendi, Valle pirrike, Palokë Kurti, Pjetër Gaci.

## “Princesha Argjiro”

Frymëzuar nga poema e Ismail Kadaresë

Regjia: Joana Omeraj

**Të shtunën**

Ora: 11:00

### Teatri i Metropolit

“Princesha Argjiro” titullohet premiera e re për fëmijë, një përshtatje e frymëzuar nga poema e Ismail Kadaresë. Kjo vepër do të vi jë në skenë në mënyrë narrative, duke përfshirë në këtë rrëfim një gamë të gjerë etydesh që e bëjnë më aktive dhe vepruese poemën.

“Narratori do të vendoset dhe në rolin e gjyshit që i tregon mbesës përralla çdo fundjavë dhe kësaj here rradhën e ka historia jonë shqiptare, historia e Gjirokastrës. Çdo etyd do të sillet nëpërmjet syve të vogëlushes Gresa, në mënyrë që të zvogelohet dramaticiteti që përmban poema dhe të përshtatet më shumë me publikun e fëmijëve” tregon Joana Omeraj, regjisorja e shfaqjes. Sipas saj dritat, ngjyrat dhe efektet do të jenë dhe në funksion të traditave tona shqiptare duke i veshur të gjithë pjestarët e etydeve dhe shfaqjes me kostume popullore tradicionale. Pjesë integrale e shfaqjes do të jenë edhe disa punime në pikturë të artistit Anasatas Kostandini, të cilat do të projektohen në skenë. Shfaqja është ndërtuar me valle, kërcime e lojra të ndryshme, duke u bazuar mbi tradita e zakone shqiptare për t’i bërë fëmijët jo vetëm pjesë të shfaqjes por edhe të mësojnë kulturën tonë të këngëve e valleve shqiptare e njëkohësisht duke ju ngacmuar atyre imagjinatën dhe kuriozitetin për kulturën tonë shqiptare.

As/regjisor: Roerd Toçe

Koreograf: Sedmir Memia

Skenograf: Anastas Kostandini

Kënga: Ketjona Pecnikaj

Muzika: Ansambli Tirana

Interpretojnë: Ligoraq Riza, Luisa Dinellari, Ketjona Pecnikaj, Sedmir Memia, Silvana Brahimataj, Stiv Osmanaj, Megi Duka, Mario Bali

Info & Rezervime:

+355 67 227 0668

[www.teatrimetropol.al](http://www.teatrimetropol.al)

## “Borëbardha dhe shtatë xhuxhat”

**Data: 14 maj**

Ora: 11:00

QKKF


Micro folie, Kryeministria

**Data: 29 maj**

Ora: 11:00

**Qendra Kulturore,  
Peshkopi**

Vjen, si asnjëherë tjetër, një koncept i ri, modern dhe mjaft argëtues i përrallës klasike aq të dashur për fëmijët “Borëbardha dhe shtatë xhuxhat”. Mesazhet e bukura që përcjell vepra janë të provuara. Humori dhe magjia skenike e kësaj shfaqjeje janë të garantuara.



## “Djali miliarder”

Turi shëtitës

**Data: 12 maj**

Ora 11:00

**Qendra Kulturore, Rrogozhinë**

E keni menduar ndonjëherë si do të ishte nëse do të kishit 1 miliard sterlina? Njihuni me Xho Pataten, djaloshi që ka gjithçka, përveç shokëve. Ai i kërkon babait të tij që të transferohet në një shkollë publike ku askush nuk e njeh dhe do mund ta mbajë sekret faktin që është një miliarder. Aty ai njihet me Bobin, shokun e tij të ri, dhe aventurat fillojnë për të dy.

A do mundet Xho ta mbajë sekretin deri në fund? A do të ketë ai më në fund një shok të vërtetë? A janë paratë gjëja më e rëndësishme?

Përgjigjet i gjeni në teatër.

Ju njoftojmë se biletat mund të tërhiqen vetëm pranë Teatrit. Për shkak të masave anticovid -19 kapaciteti i publikut është i reduktuar.

## “Na ishte njëherë”

Shfaqja teatrale me kukulla

**Data: 07, 15 maj**

Ora: 11 : 00

Salla e koncerteve “Tonin Harapi” Liceu artistik “Jordan Misja”

Ekspozitë me punime në skulpturë nga fëmijët e kursit të skulpturës të QKKF

**QKKF**

**Data: 10 maj**

Ora: 11:00

Reja, Tiranë

## “Tre Derrkucët”

Shfaqja teatrale me kukulla

**Data: 14 maj**

Ora: 11:00

**QKKF**

Salla e koncerteve “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

**Data: 19 maj**

Ora: 11:00

**Pallati i Kulturës, Kamzë**

**Data: 28 maj**

Ora: 11:00

## Shfaqja teatrale me kukulla “Vitaminat e jetës”

QKKF

**Data: 21, 22 maj**

Ora: 11:00

Salla e koncerteve “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

**Data: 25 maj**

Ora: 11:00

Teatri Aleksandër Moisiu, Durrës  
Qendra Kulturore, Peshkopi

## Festivali Kombëtar i këngës tradicionale shqiptarë për fëmijë

QKKF

**Data: 30, 31 maj**

Ora: 18 : 00

Salla e koncerteve “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

## “Një ditë me kuratorin”

me nxënësit e shkollës “Ismail Qemali”

**Data: 5 maj**

Ora: 10 : 00

Muzeu Historik Kombëtar, Pavijoni i LANÇ 05/05/2022 10 : 00

## “Një ditë me kuratorin” me nxënësit e shkollës “Protagonistët”

**Data: 5 maj**

Ora: 11 : 00

Muzeu Historik Kombëtar, Pavijoni i LANÇ 05/05/2022 11 : 00

## “Arkeologu i vogël”

**Data: 12 maj**

Ora: 10:30

Muzeu Historik Kombëtar, Atrium

## Java e Europës 2022

**Data: 3 maj**

### **Shkodër**

Muzikë, shfaqje artistike, një panair, shfaqje filmash & diskutime.

Ora: 11:00 - 18:00

### **Sheshi përballë Bashkisë - Pedonale**

Panair në shesh me produkte lokale të zonës, ofertën turistike, punime artizanale dhe argëtim për më të vegjëlit.

Ora: 13:00 - 14:00

### **Parku në Pedonale**

“Integrimi Evropian nga perspektiva e të rinjve”, do të jetë tema e diskutimit mes studentëve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, Kryetarit të Bashkisë Shkodër dhe Ambasadorëve nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Ju ftojmë të bëheni pjesë e diskutimit.

Ora: 14:00 - 15:00

### **Pedonalja në Shirokë**

Dita vazhdon me një tour mbi kajak, mundësuar nga Drini Times, financuar nga BE.

Ora: 15:00 - 16:00

### **Sheshi përballë Bashkisë - Pedonale**

Ambasadorët e Rinj evropianë ju ftojnë në pedonale për një diskutim të hapur mbi sfidat më të cilat të rinjtë shqiptarë përballen çdo ditë. Në takim do të diskutohet edhe për çeljen e thirrjes për t’ju bashkuar skuadrës sonë të Ambasadorëve të Rinj Evropianë.

Ora: 15:00 - 16:00

### **Qendra Arka**

Në bashkëpunim me Ambasadën Austriake shfaqim dokumentarin “Bota e djeshme – Kujtimet e një evropiani”, mbi jetën & karrierën e novelistit të njohur austriak Stefan Cvajg. Një diskutim i hapur do të pasojë shfaqjen e dokumentarit.

Ora: 16:00 - 18:00

### **Sheshi përballë Bashkisë - Pedonale**

“Pajtimi”, filmi fitues në kategorinë Balkan Dox në Dokufest 2021, që trajton çështjen e besës në trojet shqiptare do të shfaqet para premierë në pedonalen e qytetit. Organizuar në bashkëpunim me Ambasadën e Sllovenisë, shfaqja e filmit do të ndiqet nga një diskutim duke përfshirë edhe regjisoren Marija Zidar.

Ora: 18:00 - 19:00

### **Sheshi përballë Bashkisë - Pedonale**

Performanca artistike e grupit instrumental “The Door” do të çelë diskutimin mbi gjuhën e urrejtjes tek grupet e marginalizuara në shoqërinë shqiptare, me përfaqësues nga Delegacionit i BE-së, Këshillit të Evropës, profesionistë të fushës etj.

Ora: 18:00 - 19:00

## **Qendra Arka**

“Jeta urbane në tri qytete; Shkodër, Korçë, Tiranë”, një dokumentar i realizuar nga “Argjiro” dhe i financuar nga Bashkimi Evropian, do të na rikthejë pas në vitet e krijimit të identitetit të tre prej qyteteve kryesorë shqiptarë. Hyrja është e lirë!  
Ora: 18:00 - 22:00

## **Sheshi përballë Bashkisë - Pedonale**

Kalo nga sheshi në darkë dhe dëgjo një super performancë muzikore nga Dj Geri Syka, Orges Toçe & Shkodra Elektronike Band.

## **5 maj**

## **Vlorë**

Ora 19:00

Salla e Universitetit “Ismail Qemali”

Një koncert nën tingujt e muzikës lirike të artistëve grekë & shqiptarë. Ky event organizohet në bashkëpunim me Ambasadën e Greqisë.

Ora: 19:30

E vendosur në Lungomare, skena do të elektrizohet nga muzika e Dj Amer Doux.

Ora: 21:00

Dyshja fantastike e muzikës live që gjithmonë di të ndezë atmosferën, Marsela Çibukaj dhe Vitmar Basha do të ngjiten në skenë për të përmbyllur aktivitetet në qytetin bregdetar të Vlorës.

## Tirana International Watercolor Festival

Edicioni IV

**Datat: 4-14 Maj 2022**

Muzeu Historik Kombëtar dhe GAT /  
Galeria e Artit, Tiranë

Tirana International Watercolor Festival organizohet nga Shoqata Kulturore "VIZart". Ky edicion shenon një ngjarje të rëndësishme bashkohore në artit pamor. Me dy ekspozita paralele në hapësirat e Muzeut Historik Kombëtar dhe në GAT / Galerinë e Artit, Tiranë do prezantohen artistë novatorë, ambiciozë që vijne në disiplinë të ndryshme.



## TIRANA INTERNATIONAL WATERCOLOR FESTIVAL 4<sup>th</sup> edition

4-14  
MAJ  
2022

Muzeu Historik Kombëtar  
dhe Galeria e Artit Tiranë,  
Tirana, (Albania).



## “Vdekja e Kalit”

Data: 6-31 maj

Regjia: Saimir Kumbaro

Ora: 18:00

KINOJONË

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit  
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit është i lumtur të ndajë me ju lajmin se kinemaja e institucionit do të jetë në dispozicion të publikut për shfaqje në ekranin e madh të filmave në ditët dhe oraret e kërkuara nga publiku duke futur nga e premtja, datë 6 maj 2022.

Programi @KINOJONË do të nisë me shfaqjen e filmit “Vdekja e Kalit” (Saimir Kumbaro 1992) në versionin e tij digjital të restauruar, një shfaqje që ndodh paralelisht me shfaqjen në arte.tv (mars-qershor 2022), platformë që promovon kinematografinë europiane dhe që e ka shtrirjen territoriale në vendet e EU, EFTA, UK dhe Zvicër.

Duke qenë se arte.tv nuk e mbulon territorin shqiptar dhe filmi i restauruar “Vdekja e kalit” nuk mund të shihet nga publiku në Shqipëri, AQSHF do ta verë atë në dispozicion të publikut me shfaqje në sallën e kinemasë në AQSHF. Jemi të lumtur që arti dhe kultura mund të kapërcejnë kufijtë që vendos gjeopolitika dhe jemi krenarë që kinematografia shqiptare është tashmë pjesë e kinematografisë europiane duke u promovuar krahas 19 vendeve të tjera në programin ArteKino Classics në arte.tv.

Çdo ditë pas datës 6 maj 2022 dërgoni kërkesën tuaj për shfaqje në adresën [info@aqshf.gov.al](mailto:info@aqshf.gov.al) duke lajmëruar titullin e dëshiruar nga fondi i AQSHF-së si dhe datën dhe orarin e parapëlqyer. Stafi i AQSHF-së do t’ju kontaktojë për konfirmimin.

@KinoJONË



### VDEKJA E KALIT para-pas restaurimit

Venue: AQSHF  
06/05/22-18:00

## “VERA E FUNDIT. Falcone e Borsellino tridhjetë vjet më pas”

**Data: 08 maj**

Nga: Claudio Fava

Regjia: Chiara Callegari

Ora: 19:00

Me: Simone Luglio Giovanni Santangelo

Muzika origjinale: Salvatore Seminator

Produksini: Teatro Metastasio di Prato  
në bashkëpunim me  
CHINNICHINNACCHI Teatro



**Teatri Metropol, Salla “Shakespeare”**

Tridhjetë vjet nga masakrat e Capaci dhe Via D’Amelio.

“Vera e fundit. Falcone e Borsellino, 30 vjet më pas”, përshkon muajt e fundit të jetës së dy gjyqtarëve palermitanë. Fakte të njohura dhe më pak të njohura, publike dhe intime, si stacionet e via crucis, për të rrëfyer, jashtë kronikës dhe larg keqardhjes, forcën e atyre burrave, humanizmin, ndjenjën e tyre të thellë ndaj Shtetit. Por edhe gëzimin, ironinë, inatin dhe mbi të gjitha vetminë ku u gjendën. Ditari civil i dy burrave, jo i dy heronjve.



## “Betejat e Gjergj Kastriotit Skënderbeut për mbrojtjen e Evropës”

**Data: 4 maj**

Ora: 17 : 00

Muzeu Historik Kombëtar  
Pavijoni i Mesjetës

## “Qyteti antik i Amantias si pjesë e kulturës evropiane”

Bisedë me Dr. Jamarbër Buzo nga Instituti i Arkeologjisë

**Data: 5 maj**

Ora: 12:00

Muzeu Historik Kombëtar, Pavijoni i Lashtësisë

## “Fuqia e muzeve”

Konferencë shkencore ndërkombëtare  
në bashkëpunim me ICOM Albania

**Data: 18 maj**

Ora: 10:00

Muzeu Historik Kombëtar, Salla “UNESCO”

## “Dita Ndërkombëtare e Muzeve”

**Data: 18 maj**

Ora: 11:00

Muzeu Historik Kombëtar, Atrium

## FALCONE E BORSELLINO 30 ANNI DOPO

Konferencë

**Data: 09 maj**

Ora: 17:00

Salla e Qendrës Kulturore e Katedrales Orthodoxke

Ambasciata d'Italia, në bashkëpunim me l'istituto Italiano di Cultura di Tirana e l'Esperto della Guardia di Finanza

"Kultivimi i Kujtesës është ende sot një vaksinë e çmuar kundër indiferencës dhe na ndihmon, në një botë plot me padrejtësi dhe vuajtje, të kujtojmë se secili prej nesh ka një ndërgjegje dhe mund ta përdorë atë."

Liliana Segre

Konferenca "Falcone e Borsellino, 30 vjet më pas" synon të ndërthurë kujtesën dhe aktualitetin në kontrast me fenomenin mafioz kriminal dhe kulturën që e ushqen atë, duke promovuar një pedagogji qytetarie aktive, të bazuar tek idealet dhe parimet frymëzuese të Kushtetutës italiane.

Kujtesa është një akt i plotë marrje përgjegjësie shoqërore kur kthehet në ushtrim të vetëdijshëm të të drejtave dhe praktikë e detyrave të afërimitit qytetar. Lufta kundër pushteteve kriminale kërkon konsolidimin e urës që bashkon të shkuarën me të tashmen për ta parë të ardhmen si një kohë shprese dhe mundësisht të reja kohezioni politik dhe shoqëror. Rrëfimi kthehet në qëndrueshmëri kur fjalët e së dje-shmes marrin në të tashmen një forcë shprehëse të ripërtërirë duke u shndërruar në shembull dhe model.

Simpoziumi synon të eksplorojë këto kategori interpretuese përmes një debati shumëzërash, duke u ndalur si në rindërtimin historik të klimës së atyre viteve, ashtu edhe tek strategjitë e mëpasshme të kontrastit rregullator, gjyqësor dhe kulturor të fenomenit kriminal me origjinë mafioze.



## Përurim i librit poetik “Gjashtëmbëdhjetë udhë përpjetë malit” i shkrimtarit Kristofer Leandroer.

**Data: 5 maj**

Ora: 11:30

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

## Lexojmë dhe përkujtojmë Molierin

Në 400-vjetorin e lindjes së tij

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

**Data: 10 maj**

Ora: 10:00

## Ceremonia e shpalljes së fituesit të çmimit “Vehxhi Buharaja”.

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

**Data: 12 maj**

Ora: 10:00

Berat

## “Impakti i letërsisë në zhvillimin e shoqërive të reja”

Seminar

Në bashkëpunim me Bashkinë Kamzë.

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

**Data: 13 maj**

Ora: 11:00

Pallati i Kulturës “Artan Çuku”, Kamzë

## Ceremonia e shpalljes së fituesit të Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj

**Data: 17 maj**

Ora: 11:00

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Në kujtim të veprës së shkrimtarit për fëmijë Shkëlzen Zalli

**Data: 18 maj**

Ora: 11:00

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Ceremonia e shpalljes së fituesve të Fondit për Përkthimin Letrar nga Gjuha shqipe në Gjuhë të Huaj

**Data: 26 maj**

Ora: 11:00

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit